

KONTRATE THEMELIMI E SHOQERISE SE THJESHTE DHE STATUT
“ ONE THE RUN”

Sot me date 23.06.2023, anetaret:

- 1- Gafurr Keta i biri i Haki, mbajtes i dokumentit ID me nr. 033242170 dhe nr.Personal I60613090W, i dtl. 13.06.1986, lindur ne Bulqize dhe banues ne Tirane.
- 2- Rigels Rajku i biri i Bashkim, mbajtes i pashaportes me nr. BB2776532 dhe nr.Personal I60927068G, dtl.27.09.1986, lindur ne Durres dhe banues ne Durres.

Te dy se bashku, me vullnetin e lire dhe te plote, rene dakort per krijimin e shoqerise se thjeshte me kushtet e meposhteme.

NENI 1

Forma, emri dhe selia

Forma e kesaj shoqerie eshte “Shoqeri e thjeshte” ne mbeshtetje te neneve 1074 e vijues te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise.

Emri i shoqerise eshte “On The Run”

Selia e shoqerise eshte ne: Njesia bashkiake nr 9, Rruga Muzaket Donbosko, Pallati Gener 2 kati 1 dera nr 5, Tirane, Shqiperi.

NENI 2

KOHEZGJATJA

Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj ne nje periudhe pa afat. Si date krijimi e saj do te jete data e rregjistrimit ne QKB.

NENI 3

FUSHA E VEPRIMTARISE

Aktivitete te tjera ne fushen e pergatitjes dhe sherbimit te ushqimeve te shpejta dhe pijeve.

NENI 4

KAPITALI

Kapitali i shoqerise eshte ne shumen 100'000 leke , i ndare ne 2 kuota, si me poshte vijon:

- Anetari Gafurr Keta me kontribut 50.000 leke, zoterues i 1 kuote te kapitalit me 50 %.



- Anetari Rigels Rajku me kontribut 50'000 leke, zoterues i 1 kuote te kapitalit me 50 %.

NENI 5

Organet drejtuese te shoqerise

Organet drejtuese te shoqerise jane:

- Administratori
- Asambleja e anetareve

NENI 6

Aministratori

Administratori menaxhon dhe perfaqeson shoqerine dhe kryen te gjitha veprimet ligjore te shoqerise. Administrador mund te jete cdo njeri nga anetaret.

Anetari qe nuk merr pjese ne administrim ka te drejte qe te marri njoftim per veprimin qe do te kryeje anetari tjeter ne cilesine e administratorit.

Veprimet e kryera nga anetari i shoqerise si administrator kane efekt mbi shoqerine ne raport me te tretet.

Administratori i shoqerise eshte Gafurr Keta per nje periudhe 5 vjecare me te drejte riemerimi.

Administratori ne mbledhjen e Asamblese se Shoqerise raporton mbi bilancin vjetor te shoqerise.

NENI 7

Asambleia e Anetareve

Asambleja e anetareve eshte organi me i larte i vendimmarrjes i shoqerise.

Asambleja e anetareve perbehet nga te gjithet anetaret e shoqerise.

NENI 8

Funksionet e Asamblese se anetareve

Ka funksion primar vendimmarrjen dhe mbikqyrjen e veprimtarise se shoqerise.

Shqyrton ceshtjet ekonomike, financiare dhe te administrimit, si dhe miraton aktet me te rendesishme ne lidhje me shpenzimet per vitin ne vazhdim, miratimin e bilancit ne fund te vitit dhe ndarjen e fitimit.

Asambleja mblidhet te pakten nje here ne vit.

Anetaret e asamblese jane te gjithet individet te cilet kane statusin e anetarit te kesaj shoqerie.

Me vendim unanim te Asamblese mund te shtohen anetare te rinj.

Me vendim te Asamblese mund ti kalohen kuotat nje anetari tjeter.

NENI 9

MBYLLJA E SHOQERISE

Shoqeria mbyllet me marreveshje te anetareve.

Me mbylljen e shoqerise percaktohen dhe te drejtat e perdorimit te emrit te shoqerise. Cdo anetar ka te drejte te largohet nga shoqeria ne cdo kohe.

Pas largimit, anetari ka te drejte te ushtroje te njejten veprimtari , por nuk mund te perdore emrin dhe e-mail-in e shoqerise.

NENI 10

Per rregjistrimin e shoqerise ne QKB ngarkohet administrator z. Gafurr Keta.

ANETARET E SHOQERISE SE THJESHTE

Gafurr Keta

(Emer, Mbiemer, Firme)

GAFURR KETA


Rigels Rajku

(Emer, Mbiemer, Firme)

Rigels Rajku
